

VENDIM
Nr.711, datë 18.11.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.151, DATË 25.4.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STATUSIN “DËSHMOR I ATDHEUT”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neni 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8607, datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “a” e pikës 1 të vendimit nr.151, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të ndryshohet si më poshtë vijon:

a) Përbërja e komisionit qendror për statusin “Dëshmor i Atdheut”, pranë Këshillit të Ministrave, të jetë:

- | | |
|---------------------------------|-------------|
| - zëvendëskryeministri | kryetar; |
| - zëvendësministri i Mbrojtjes | nënkryetar; |
| - zëvendësministri i Drejtësisë | anëtar |
| - zëvendësministri i Brendshëm | anëtar; |
| - zëvendësministri i Punës, | |
| Çështjeve Sociale dhe Shanseve | |
| të Barabarta | anëtar; |
| - një përfaqësues i Organizatës | |
| Kombëtare të Familjeve të | |
| Dëshmorëve të LANÇ-it dhe | |
| dëshmorëve të tjerë të Atdheut | anëtar; |
| - një përfaqësues i Organizatës | |
| së Bashkuar të Veteranëve | |
| të Luftës që mbulon familjet e | |
| dëshmorëve të Atdheut | anëtar. |
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha